

PLANI DITOR

Fusha mësimore: Gjuhë shqipe dhe komunikim

Klasa: II

Kohëzgjatja e orës: 40 min

Njësia mësimore: Mos e prej lex f .51

Rezultatet e të nxënit :

Në fund të orës mësimore, nxënësit do të jenë në gjendje të :

* **Lexojnë rrjedhshëm dhe pa gabime .**

* **Kuptojnë tekstin “Mos e prej ”.**

* **Analizojnë tekstin : “Mos e prej ”.**

Qëllimi i të nxënit: Të mësojmë tekstin : Mos e prej .

Materialet dhe burimet e nevojshme për mësimdhënie / aktivitete

Libri i leximit dhe fletoret , fleta

Përshtatja me nevojat e nxënësve .

Aktivitete që mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve.

Procedura e mësimdhënies dhe **plani i vlerësimit**

STRUKTURA E ORËS		TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES
EVOKIM	E	Stuhi mendimesh
REALIZIMI I KUPTIMIT	R	Drta(lexim i drejtuar)
REFLEKTIMI	R	Pesëvargësh

Pyetja kryesore për fillim: **Çfarë mendoni se dini për drurët ?**

Nxënësit përgjigjen rreth pyetjes kryesore dhe më pas shënojnë në tabelë qëllimin e të nxënit:

Të mësojmë tekstin : Mos e prej

Pastaj bashkë me nxënës nxjerrim dhe shënojnë në tabelë edhe kriteret e suksesit:

* **Lexoni mirë duke respektuar shenjat e pikësimit.**

* **Përcillni shokun ose shoqen gjatë leximit .**

* **Gjeni personazhet e tregimit.**

* **Komentoni tregimin “Mos e prej “.**

Mandëj nxënësit do t'i udhëzojë t'i hapin librat e lex f. 51

- Do të lexojnë tekstin me ndalesa dhe pas çdo ndalesë do të ketë pyetje për diskutim

- **Lexohet pjesa e parë.** Pyetje për diskutim

- **Për kë bëhet fjalë në këtë tekst?** (Për drurët) **Parashtrimi i pyetjeve**

- **Cilët janë personazhet e këtij tekst?**(druvari, bilbili, qukapiku, ketri, toka),

- **Ç'bëri një druvar ?** (Ai iu afrua trugut të një druri të vjetër.)

- **Pse ishte afruar druvari drurit të vjetër?** (Sepse ai donte të prej atë drurë.)

- **Me çfarë mjeti donte te prente drurin ?** (Me motosharrë.)

- **Ç'ndodhi me drurët?** (Drurët u dridhën nga frika.)

Vlerësimi në fillim të mësimin

Vlerësimi gjatë mësimin

Lexohet pjesa e dytë. Dhe pas leximit fillojmë diskutimin me nxënës

-Ç'mendoni per drurët ju ? (Ata i përshpëritën njëri –tjetrit duke thënë: Mjerë për ne .)

-Çka i tha bilbili druvarit? (Ciu – ciu – ciu ! Mos e prej këtë dru, - e luti një bilbil.)

-Pse e luti bilbili druvarin? (Se nuk do të kem ku ta ngre folenë.)

Lexohet pjesa e tretë. Dhe pas leximit fillojmë diskutimin me nxënës:

-Po pastaj cili shpend i foli druvarit? (**Qukapiku**)

-Çka i tha qukapiku druvarit? (Quk – quk – quk ! Mos e prej këtë dru, - tha qukapiku .)

-Pse i tha ashtu qukapiku? (Sepse nuk kam ku të ha krimba.)

Lexohet pjesa e katërt. Dhe pas leximit fillojmë diskutimin me nxënës:

- Po pastaj cila kafshë foli me druvarin? (Ketri)

- Çka i tha ketri druvarit? (Gër – gër– gër ! Mos e prej këtë dru, - tha ketri .)

-Pse i tha ashtu ketri? (Sepse nuk kam ku te bëj strofullin.)

Lexohet pjesa e pestë. Dhe pas leximit fillojmë diskutimin me nxënës:

-Po toka çfarë i tha druvarit? (Mos e prej !)

-Pse i tha toka mos e prej drurin? (Sepse bie shiu e më gërryen , më shpie poshtë në lumë.)

-Si u përgjigj druvari? (Më duhet ta prej, tha me keqardhje druvari.)

- Pse duhet të prej drurin druvari? (Sepse ky dru është tepër i vjetër .Edhe pak e thahet fare.)

- Çka bëri druvari? (Druvari e preu drurin dhe trunget e tij i dërgoi në fabrikë. Atje do të bëjnë mobilie të bukura prej tyre.)

- Çka tha druvari pastaj ? (Këtu do të mbëltoj drunj që do të rriten së shpejti.)

- Ç'bënë bilbili, qukapiku dhe ketri? (U shpërngulën përkohësisht në një dru tjetër.)

- Po toka? (Toka u bë gati të ushqente drurë të rinj.)

Pastaj me nxënësit së bashku do të punojmë një pesëvargësh në lidhje me njësinë mesimore të zhvilluar .

Druvari
i mirë i vjetër
pren mbjell kujdeset
Druvari i pren drurët e vjetër .
Njeriu

Detyrë shtëpie -Nxënësit mësojnë kuptimin dhe do të punojnë në fletore komentimin e tekstit.

Reflektimi:

Vlerësimi
pas mësimit

Procedurat e mësimdhënies nxënësve u ndihmojnë që konceptet e reja dhe njohuritë e fituara t'i shfrytëzojnë për komentime njesive te tjera .

Kritetet e suksesit janë të lidhura me fazën e realizimit – kuptimit të orës mesimore. Përmes detyrës së shtëpisë nxënësit kanë mundësi të përvetësojnë njohuritë e tyre rreth mësimit në klasë.